



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nr./No. orig. 02
Org./Instituc. 02
Nr./Faqeje 02
Nr./Stranica 02

Nr./Prot. 6782-2/23
Prot./No. 6782-2/23
Data: 05.12.23
Datum: 05.12.23

PRISHTINË / A No. 1

Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Nr. VI-278/23 Data: 30.11.2023
1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të
2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr.011/01-22934 për rritjen e tarifës për grumbullimin e mbeturinave në amvisëri, miratuar nga Kuvendi Komunal i Gjakovës, datë 23.11.2023.

I nderuar kryetar Gjini,
E nderuar kryesuese Kuqi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimin 01 Nr.011/01-22934 për rritjen e tarifës për grumbullimin e mbeturinave në amvisëri, miratuar nga Kuvendi Komunal i Gjakovës, datë 23.11.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit 01 Nr.011/01-22934 për rritjen e tarifës për grumbullimin e mbeturinave në amvisëri, miratuar nga Kuvendi Komunal i Gjakovës, në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimi 01 Nr.011/01-22934 për rritjen e tarifës për grumbullimin e mbeturinave në amvisëri, miratuar nga Kuvendi Komunal i Gjakovës, datë 23.11.2023.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr.011/01-22934 për rritjen e tarifës për grumbullimin e mbeturinave në amvisëri, miratuar nga Kuvendi Komunal i Gjakovës, konstatoi se:

Vendimi duhet të jetë i bazuar në Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, pasi me këtë ligj është plotësuar dhe ndryshuar neni 15.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. _____ /2023
Datë: 23.11.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, bazuar në nenin 12, dhe 17, pika f të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në nenin 15 pika 1.8 të Ligjit nr.04./L-060 për Mbeturina, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.11.2023, pas diskutimeve lidhur me pikën e 7 të rendit të ditës: Kërkesa për rritjen e tarifës së grumbullimit të mbeturinave për amvisëri, e miratoj këtë :

V E N D I M

Për

Rritjen e tarifës për grumbullimin e mbeturinave në Amvisëri

1. Aprovohet propozimi për Rritjen e Tarifës të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave në Amvisëri në Komunën e Gjakovës .
2. Tarifa prej 5.00€ 1/7 (një herë në javë) e caktuar në Vendimin 01 Nr.011/01-18668/2020 të datës 25.08.2020 me hyrjen në fuqi të këtij vendimi rritet në 6.80€ 1/7 (një herë në javë).
3. Përjashtim nga rritja e Tarifës së Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave në Amvisëri si në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi bëhet për Shfrytëzuesit e Asistencës Sociale .
4. Pjesa tjetër e vendimit 01 Nr.011/01-18668/2020 të datës 25.08.2020 mbetet në Fuqi .
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal .
 - Drejtorisë për Shërbime Publike .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës .
 - Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	02/11/2023
REFERENC - E:	08/Zyrtare/2023
PER/ZA/TO:	znj.Arbëneshja Kuqi – Kryesues i Asamblesë Komunale Gjakove
NGA/OD/FROM:	Albana Bakalli – Udhëheqëse e Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit
Përmes:	z.Ardian Gjini - Kryetari i Komunës z. Nikollë Lleshi – Drejtor i Shërbimeve
CC:	z. Durim Halilaj – Kryesues i Komisionit të aksionerëve KRM “Çabрати” SHA z. Behar Ferizi – Kryeshf Ekzekutiv KRM “Çabрати” SHA Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës
TEMA:	Kërkesë për rritje të tarifës së mbeturinës për amvisëri

Me anë të kësaj kërkesë, më lejoni që më poshtë të ju shtjelloj kërkesën për rishikim e tarifës së mbeturinave si pasojë e rritjes së çmimit të deponisë, të derivateve si dhe shpenzimeve operative në KRM “Çabрати” si pasojë e rritjes së inflacionit.

Gjatë viti 2022 kemi kaluar në rritjen e përgjithshme të çmimeve në të gjithë sektorët respektivisht shpenzimet operative dhe të derivateve. Gjithashtu në fund të vitit 2022 Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Ekonomisë ka marrë vendim për rritjen e tarifës së deponimit, 3 cila tarifë është rritur nga 5,31€ në 7.31€, ku ky vendim e përcakton që çdo vite pasues, çmimi do të rritet për (1) euro çdo vitë.

Vendimi me nr.3148 të datës 02.12.2022 për rritjen e tarifës së deponimit të mbeturinave komunale në deponitë e menaxhuara nga KMDK nga çmimi aktual 5.31 € euro në 7.31 € euro për ton (e shprehur në % rritje e çmimit në vlerë prej 37.6%, e cila hyri në fuqi me 1 Janar 2023, ku duhet cekur se kjo tarifë do të rritet për 1 € çdo vit pasues duke përfshi edhe vitin 2027, andaj referuar analizës së kostove të hyrat aktuale për grumbullim dhe transportim të mbeturinave nuk do të mund të mbulojnë koston për kryerje të shërbimeve efektive ndaj qytetarëve si dhe pamundësojnë realizimin e planit të biznesit për KRM “Çabрати” SHA. (Vendimi i Bashkangjitur)

Ju ju informojmë se që nga data 26 Korrik 2023 kemi pranuar nga KMDK njoftimin që sasia e mbeturinave nga KRM "Çabrat" SHA, në DS Landovicë- Prizren do të pranohet vetëm 50ton/ditë (ku realisht, KRM "Çabrat" në një mesatare vjetore, mbledh mbeturina deri në 90 ton në ditë), me arsyetimin që sipas menaxhmentit të tyre, nuk kanë hapësirë për pranimin e mbeturinave të deponisë së vjetër të-Gjakovës, ose sasi të mëdha të pastrimit të deponive të vjetra, për shkak se me sasi të tilla është stërngarkuar deponia e Prizrenit. Andaj jemi të detyruar që mbeturinat t'i dërgojmë në deponitë tjera konkretisht në Obiliq apo qytetet tjera ku për KRM"Çabrat" kjo do të ndikojë në rritje të kostos së shpenzimeve si dhe të derivateve po ashtu edhe atyre operative.

Sa për ilustrim mesatarja e çmimit të derivateve pa tvsh për vitin 2021 ka qene 0.86 euro, mesatarja e çmimit për vitin 2022 ka qene 1.31 euro, ndërsa për vitin 2023 çmimi aktual (1.45 euro), ku rritja është për 42.89% më e lartë se në vitin 2021.

Nga sa u tha më lartë kërkojmë nga Asambleja Komunale që të mbështesni propozimin tonë për rritje të çmimit për shërbimet e ofruara për kategorinë Amvisëri, kurse për kategori tjera çmimet do të mbesin ashtu siç janë deri në ndonjë vendim tjetër.

Duke marrë parasysh këto rrethana , Sektori i Menaxhimit të Mbeturinave dhe Ambientit- DSHP, në bashkëpunim me operatorin KRM"Çabrtin", ka bërë analizën, e cila do të paraqitet më poshtë, duke marrë parasysh shkallën e inflacionit, vendimin e Qeverisë për rritje të çmimit të KMDK për 2023 dhe për çdo vite me radhë, si dhe rritjen e çmimit të derivateve të cilat rezultojnë në rritje të tarifës për kategorinë Amvisëri me 36%, respektivisht nga çmimi 5 euro në 6.80 (me tvsh).

Sqarim:

1. KMDK						
viti	çmimi	Sasia ne ton	totali €	çmimi pa TVSH	TVSH	çmimi me tvsh
2022	5.31	24,805.4 7	131,717.0 5	131,717.0 5	10,537.3 7	142,254.4 2
2023	7.31	22,689.9 8	165,863.7 3	165,863.7 3	13,269.1 0	179,132.8 3
Diferenca			34,146.68			
Numri i konsumatoreve Amvisëri			14200			
Rritje e çmimit pa TVSH në 2023			2.00			
Rritja e çmimit në %			37.66%			
Rritje e çmimit pa TVSH me 1 Janar 2024			3.00			
Rritja e çmimit në %			56.50%			

2. Derivatet					
viti	sasia lit.	Mesatarja e çmimit pa TVSH	çmimi	vlera pa tvsh	totali me tvsh
2021	169,654.02	0.86	1.02	146,985.37	173,443.21
2022	174,419.81	1.30	1.54	228,090.57	269,147.80
2023 (çmimi actual)	94,650.80	1.08	1.27	102,283.12	120,694.85
Numri I konsumatorëve Amvisëri				14200	
Rritje e çmimit pa TVSH				25.58%	

Kalkulimi :

Rritja e KMDK 37.66 + rritja e derivateve dhe shpenzimet operative 38.72% = 76.38% (mesatarja 38.19%)

Rritja e KMDK 56.50 + rritja e derivateve dhe shpenzimet operative 38.72% = 95.22% (mesatarja 47.61%)

- Çmimi aktual për Amvisëri pa TVSH është $4.60 + 38.19\% = 6.35$ euro + 8% TVSH = 6.85 euro (është kalkuluar KMDK & çmimi i naftës për vitin 2023)
- Çmimi aktual per Amvisëri pa TVSH është $4.60 + 47.61\% = 6.79$ euro + 8% TVSH = 7.33 euro (është kalkuluar KMDK & çmimi i naftës për vitin 2024)
- Çmimi aktual per Amvisëri pa TVSH është $4.60 + 37.66\%$ KMDK = 6.33 euro + 8% TVSH = 6.83 euro (është kalkuluar vetëm KMDK për vitin 2023)
- Çmimi aktual per Amvisëri pa TVSH është $4.60 + 56.50\%$ KMDK = 7.20 euro + 8% TVSH = 7.77 euro (është kalkuluar vetëm KMDK për vitin 2024)
- Çmimi aktual per Amvisëri pa TVSH është $4.60 + (25.58\% \text{ derivate} + 13.14 \text{ shpenzimet operative}) 38.72\% = 6.38$ euro + 8% TVSH = 6.89 (kalkulimi çmimi i naftës, KMD dhe shpenzimet operative)

Duke i kalkuluar të gjitha kostot e lartë cekura, çmimi real për amvisëri del të jetë **6.80 €**.

Si përfundim kërkojmë nga ju që ta shqyrtoni dhe ta merrni në konsideratë ngritjen e tarifës për vitin pasardhës duke nisur prej fillimit të vitit 2024 , me qëllim të mos cenimin financiar të KRM “ Çabrat”, ku mund të reflektoj me pasoja të mos operimit efikas, ndikim në mjedis dhe mirëqenien e qytetarëve.


Nga sa u tha më lartë kërkojmë nga Kuvendi Komunal që të mbështesni propozimin tonë për rishikimin e tarifës për shërbimet e ofruara për kategorinë **Amvisëri**, kurse për kategori tjera çmimet do të mbesin ashtu siç janë të përcaktuara në Vendimin e Kuvendit Komunal me nr. 01-011/01-18668/2020 të datës 25/08/2020.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS



OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, bazuar në nenin 12, dhe 17, pika f të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në nenin 15 pika 1.8 të Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.08.2020, pas diskutimeve lidhur me pikën e 4 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Rekomandimit të MAPL-së për rishqyrtim të Vendimit 01nr011/01-14048 të dt. 25.06.2020 për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, e miratohet kështu :

V E N D I M

Për

Caktimin e tarifave të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave

1. Aprovohet propozimi i Drejtorisë për Shërbime Publike për caktimin e tarifave të shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave sipas të dhënave vijuese :

-Tarifa e Amvisërisë

Kategoria 1 -----5.00€ 1/7 (një herë në javë)

Kategoria 2 -----15.00€ Vjetore

-Tarifa e Bizneseve


- Nënkatëgoria 1 gjeneruesit e mbetjeve me kapacitet të Vogël ----5.00€ 1/7 (një herë në) javë
-----7.00€ 2/7(një herë në) javë
- Nënkatëgoria 2 gjeneruesit e mbetjeve me kapacitet të Mesëm ----6.20€ 1/7 (një herë në)javë
-----8.00€ 2/7(një herë në) javë)
- Nënkatëgoria 3 gjeneruesit e mbetjeve me kapacitet të madhe, Zbrazja me Kontejner 1.1m³-----
12.20€ (një herë në javë) sipas listës përcjellëse
- Nënkatëgoria 3 gjeneruesit e mbetjeve me kapacitet të madhe, Zbrazja me Kontejner 7.1m³-----
46.20€ (një herë në javë) sipas listës përcjellëse .
- Zbrazja e kontejnerëve 120 litra sipas Listës Përcjellëse 1.50€ 1/7 (Një herë në Javë) .
- Zbrazja e kontejnerëve 240 litra sipas Listës Përcjellëse 2.50€ 1/7 (Një herë në Javë).
- Zbrazja e kontejnerëve 1.1m³ me mbetje Shtazore sipas Listës Përcjellëse 25.00€ .

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi do të fillon aplikimi i tarifave të reja të shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave në Komunën e Gjakovës sipas pikës së parë të këtij vendimi .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës
4. -Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal .
 - Drejtorisë për Shërbime Publike .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës .
 - Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shafa





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

Ministria e Ekonomisë, në mbështetje të neneve 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturinë, nenit 11 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8 paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

1. Caktohet tarifa e deponimit të mbeturinave komunale në deponitë e menaxhuara nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) ShA në lartësi prej shtatë euro e tridhjetë e një centë (7,31) për ton, e zbatueshme nga 1 janari 2023.
2. Tarifa nga pika 1 e këtij vendimi rritet për një (1) euro më 1 janar të secilit vit pasues, duke përfshirë vitin 2027, dhe mund të rishikohet sipas nevojës për të siguruar qëndrueshmërinë financiare, operative dhe mjedisore të KMDK-së.
3. Obligohet KMDK të zbatojë këtë vendim.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

KMDK, ndërmarrje publike, menaxhon katër deponi sanitare dhe një stacion transferi të mbeturinave komunale. Tarifa e deritanishme 5,31 euro për deponimin e një toni të mbeturinave ka qenë e pamjaftueshme për të siguruar qëndrueshmërinë financiare, operative dhe mjedisore të KMDK-së. Rritja e tarifës, si në dispozitiv, bëhet në marrëveshje me komunat përkatëse.



U dërgohet:

- MMPHI
- Kabinetit të Ministres
- Të gjitha komunave
- Sekretarit të Përgjithshëm të ME-së
- KMDK ShA
- NjPMNP
- Arkivit